

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

P.nr.697/2016

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rafet Ismajli, dhe Proceśmbajtesin Albion Behrami, duke vendosur ne çēshtjen penale ndaj te pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] komuna e [REDACTED] ku edhe jeton, për shkak te veprës penale "Kanosja" nga neni 161 parag.4 lidhur me parag.1 të KPK-së i akuzuar sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore në Mitrovicē-departamenti i përgjithshëm PP-II.nr.1042/2015, te dt.11.10.2016, duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor pa mbajjen e shqyrtimit gjyqësor, me dt.16.11.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Mitrovicē-departamenti i përgjithshëm PP-II.nr.1042/2015, te dt.11.10.2016, dhe gjykata e jepe këtë.

U R D H E R N D E S H K I M O R

I pandehuri [REDACTED] nga i ati [REDACTED], e ema [REDACTED] e gjinis [REDACTED], i lindur me dt. [REDACTED] në fsh. [REDACTED] komuna e [REDACTED] ku edhe jeton, Shqiptar, Shueta s i Republikës së Kosovës, me numër personal. [REDACTED] i martuar, me profesion taksist, ka te kryer shkollën e mesme.

E S H T E F A J T O R

SEPSE: Me datë 06.11.2012 rreth orës 08.50 min, në fsh. [REDACTED] komuna e Mitrovicēs, saktësisht tek [REDACTED], seriozisht ka kanosur personat zyrtar ne lidhje me punën dhe pozitën e tyre zyrtarë dhe atë te dēmtuarit : [REDACTED] dhe [REDACTED] te dy zyrtar doganor, te cilët e kanë ndaluar te pandehurin i cili ishte duke drejtuar automjetin e tije kombi me targa [REDACTED], atēherë i pandehuri iu ka drejtuar me fjalët "ju po na pengoni, po vini nga Gjakova dhe nuk po na lini te qete" e pastaj i ka kërcēnuar me fjalët "pasha kryet e tre fëmijëve, neqoftëse me ndaloni edhe një here, unë nuk do te ndalem dhe do te ju shkel me automjet,

Me këtë ka kryer veprë penale "Kanosja" nga neni 161 parag.4 lidhur me parag.1 të KPK-së

Andaj gjykata ne baze te kesaj dispozite ligjore e lidhur me nenin 4, 7, 17, 41,46, dhe 73 te KPRK-se, dhe nenet 450, 453 par.1 ,463 par 1 dhe 7, 495 dhe 365 te KPP-se, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobe ne shume prej 200 €/dyqinde /euro të cilin dënim është i obliguar ta paguaj ne afat prej 30 ditësh prej ditës se plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobe nuk mund te realizohet, ne baze te nenit 46 te KPRK-se, i njëjti te pandehurit do t'ju zëvendësohet me dënim me burg, duke llogaritur ç' do 20 /njëzet/ euro me 1 /një/ dite burgim.

Obligohet i pandehuri qe ne emër te shpenzimeve te procedurës penale te paguaj shumen prej 20 € si dhe ne emër te paushallit gjyqësor shumen prej 10 €, i cili është i obliguar qe ti paguaj ne afate prej 30 ditësh pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar për realizimin e demit, gjykata e udhëzon ne kontest te rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë-departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.1042/2015, te dt.11.10.2016, kundër te akuzuarit [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] komuna e [REDAKTUAR], ku edhe jeton, për shkak të veprës penale "Kanosja" nga neni 161 parag.4 lidhur me parag.1 të KPK-së

Prokuroria nga gjykata ka kërkuar qe kundër te akuzuarit te jepet urdhër ndëshkimor- shqiptimin e dënimin me gjobe pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësore.

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak te aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhrin ndëshkimore ne kuptim te nenit 495 te KPPK-së.

Gjykata vlerësoj se ne shkresat e lendes ekzistojnë prova te besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimore te cilat e vërtetojnë faktin se i pandehuri i ka kryer veprën penale ne fjalë si: Shkresat e policisë 2012-BC-1666 raporti policor i dt.06.11.2012, shënimi zyrtar i kësaj date, vendimi mbi referimin e lendes për ndërmjetësim i dt.07.10.2015 si dhe u be vështrimi ne shkresat e tjera te lendes.

Gjykata duke u bazuar ne këto prova te besueshme vërtetoi se ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale "Kanosja" nga neni 161 parag.4 lidhur me parag.1 të KPK-së

Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj te pandehurit gjykata i pati parasysh te gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese te parapara ne nenin 73 te KPRK-së, e ne rastin konkret për te njëjtin rrethane lehtësuese gjeti, se i njëjti më parë nuk ka kryer vepër penale, sjelljen e mëparshme te kryesit, rrethanat personale të kryesit dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale. Ndërsa rrethane rënduese gjeti faktin se vepra penale te kësaj natyre janë ne rritje e sipër, dhe se i pandehuri ka shkaktuar frik dhe pasiguri tek te dëmtuarit. Andaj duke u bazuar ne rrethanat rëndues dhe lehtësuese të cekura si me larte gjykata te akuzuarit i shqiptoj dënim si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, duke pritur me te drejte se me dënimin e shqiptuar do te arrihet qëllimi i dënimin i parapare sipas-nenit 185 te KPRK-së.

Ne baze te nenit 463 par 1 dhe 2 te KPK-së, i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike gjykata e udhëzoj ne kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e mori duke u bazuar ne nenet 450 dhe 453 par. 1 te KPK-së. Nga se u tha me larte u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

Departamenti i përgjithshëm
P.nr.697/2016 me datë 16.11.2017.

Procesmbajtësi:

Albion Behrami

Gjyqtari i vetëm gjykes

Rafet Ismajli

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund te ushtrohet kundërshtim ne afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim se këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë ne procesverbal te kësaj gjykate.